



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2417/2 Prot.

Tiranë, më 27. 10.2025

V E N D I M

Nr. 45, datë 27. 10.2025

“PËR MIRATIMIN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMIN E INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË “MJEKËSI E PËRGJITHËSHME”, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026”

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, neni 6, pika 30, neni 47 dhe neni 49; të Statutit, neni 5, 49 dhe 51 dhe Rregullores së UMT-së; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 21.05.2018, i ndryshuar, të propozimeve të Fakultetit të Mjekësisë me shkresën nr. 947/1 prot., datë 14.04.2025, si dhe të Vendimit të Senatit Akademik nr. 96, datë 03.10.2025 “Për miratimin paraprak të tarifës vjetore të shkollimit për programin e integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mjekësi e Përgjithshme”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2025-2026”, në mbledhjen e datës 27.10.2025, Bordi i Administrimit të UMT-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën vjetore të shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në programin e integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mjekësi e Përgjithshme”, për vitin akademik 2025-2026, në vlerën 45,000 (dyzetë e pesë mijë) lekë.
2. Studentët e programit të integruar të ciklit të dytë i nënshtrohen vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i cilësuar “përsëritës” në bazë të Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdon studimet.
3. Studentët, që transferojnë studimet në programin e integruar të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mjekësi e Përgjithshme” i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të vitit në të cilin ata do të transferojnë studimet.
4. Vendimi i përcillet Rektorit dhe Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

VERA OSTRENI

ANIS THODHORJANI

UNIVERSITETI I MJEKËSISË
TIRANË
NËNKRYETAR
MONIKA FIDA
ANËTARË
ALTINA XHAFFERI
VANGJUSH STAVRO

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ